



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

TELO ZA RAZMATRANJE NABAYKE

PROCUREMENT REVIEW BODY

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAYKE

632, 648, 674,
691, 700 / 20
Nr/Br. _____
Datë/Datum. 03. 12. 2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH .nr. 632/20
648/20
674/20
691/20
700/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “I.T.K” Shpk-Pejë (Lot 2), OE: “Dorearti” Shpk; “Beni com” Shpk ; “Lindi Markings” Shpk-Pejë (Lot 3), OE: “Select Prima” Shpk-Prishtinë (Lot 2, 3), OE: Grupi i OE “Sinjal RKS-SHpk (Riemruar TSR shpk) & IDK Konstuksion & 2T”-Prishtinë (Lot 2 , 3), si dhe ankesa e OE: “RSM Company” Shpk –Prishtinë (Lot 2 ,3), kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : “Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët Nacionale të Republikës së Kosovës Lot 2” me nr. të prokurimit: 205/17/3491/5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/, Ministria e Infrastrukturës/MI/, më datën: 23.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, pjesërisht si te bazuara ankesat e operatorëve ekonomik: “I.T.K” Shpk-Pejë (Lot 2), OE: “Dorearti” Shpk; “Beni com” Shpk ; “Lindi Markings” Shpk-Pejë (Lot 3), OE: “Select Prima” Shpk-Prishtinë (Lot 2, 3), OE: Grupi i OE “Sinjal RKS-SHpk (Riemruar TSR shpk) & IDK Konstuksion & 2T”-Prishtinë (Lot 2 , 3), si dhe ankesa e OE: “RSM Company” Shpk –Prishtinë (Lot 2 ,3), lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët Nacionale të Republikës së Kosovës Lot 2” me nr. të prokurimit: 205/17/3491/5-1-1, iniciuar nga AK Ministria e Infrastrukturës.

II. ANULOHET, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull: “Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët Nacionale të Republikës së Kosovës Lot 2 dhe 3” me nr. të prokurimit: 205/17/3491/5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/, Ministria e Infrastrukturës/MI/, dhe lënda të kthehet në **Rivlerësim për Lot 2 dhe Lot 3**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues “I.T.K”Shpk-Pejë, OE: “Dorearti”Shpk;”Beni com“Shpk ; “Lindi Markings” Shpk-Pejë, OE: “Select Prima”Shpk-Prishtinë, OE: Grupi i OE “Sinjal RKS-SHpk (Riemruar TSR shpk) & IDK Konstuksion & 2T”-Prishtinë, si dhe ankesa e OE: “RSM Company”Shpk -Prishtinë aprovohen pjesërisht si te bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “I.T.K”Shpk-Pejë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me dt. 04.09.2020 , me nr. 632/19 , kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët Nacionale të Republikës së Kosovës Lot 2” me nr. të prokurimit: 205/17/3491/5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/, Ministria e Infrastrukturës/MI/ , duke pretenduar se:

Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7, 59, 60, dhe 62 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës. Rregullat dhe udhëzuesi operativ për prokurimin publik sipas LPP.

Operatori ekonomik ankues: “Dorearti”Shpk;”Beni com“Shpk ; “Lindi Markings” Shpk-Pejë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me dt. 10.09.2020 , me nr. 648/19 , kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët Nacionale të Republikës së Kosovës Lot 3” me nr. të prokurimit: 205/17/3491/5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/, Ministria e Infrastrukturës/MI/, duke pretenduar se:

Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7 , 59, 62 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe neni 44 i RRUOPP-së.

Operatori ekonomik ankues: “Select Prima”Shpk-Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me dt. 17.09.2020 , me nr. 674/19 , kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët Nacionale të Republikës së Kosovës” me nr. të prokurimit: 205/17/3491/5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/, Ministria e Infrastrukturës/MI/, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7 ,10, 59, 60, 62, 69, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe neni 44.7 i RRUOPP .

Operatori ekonomik ankues: Grupi i OE “Sinjal RKS-SHpk (Riemruar TSR shpk) & IDK Konstuksion & 2T”-Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me dt. 21.09.2020 , me nr. 691/19 , kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët Nacionale të Republikës së Kosovës Lot 2 dhe Lot 3” me nr. të prokurimit: 205/17/3491/5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/, Ministria e Infrastrukturës/MI/, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 38, 56, 59, 62, D01, dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 44 të RRUOPP-së.

Operatori ekonomik ankues: “RSM Company”Shpk -Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me dt. 21.09.2020 , me nr. 700/19 , kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët Nacionale të Republikës së Kosovës Lot 2 dhe Lot 3” me nr. të prokurimit: 205/17/3491/5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/, Ministria e Infrastrukturës/MI/, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 59, 62, si dhe 105 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës .

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 22.09.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 02.10.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Lidhur me pretendimin e OE ankues "I.T.K"Shpk se AK gjatë rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se numri mesatar i te punësuarve në tri vitet e fundit(2015,2016 dhe 2017) nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosjen e tenderit,përkatësisht në Njoftimin për Informata Shtesë ose përmirësim gabimi tek kërkesa 4 është kërkuar që Mesatarja e të punësuarve (që janë në listën e pagave) në tri vitet e fundit duhet të jetë min. 10 të punësuar. Nëse oferta përfshin me shume se një LOT (Pjesë), numri i personelit duhet te rritet në varësi te numrit te lloteve për të cilat oferton.

OE "I.T.K"Shpk në ofertën e tij ka prezantuar numrin e stafit 32 për vitin 2017,për vitin 2016 ka prezantuar numrin e stafit 22 dhe për vitin 2015 numrin prej 26.

Eksperti shqyrtues konstaton se bazuar në vendimin e AK, sipas të cilit OE ankues është shpërblyer me tri lot në këtë aktivitet të prokurimit,numri i stafit të prezantuar nga OE ankues nuk e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit për kapacitet teknik dhe profesional sepse në asnjërin për vitet e lartëcekura ky OE nuk ka prezantuar staf me shume se 40 punëtorë,andaj ky pretendim është i pa qëndrueshëm.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH. nr 455-464/18 të datës 05.10.2018. Pretendimi ankimor është i pa bazuar

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Lidhur me vendimin e Autoritetit Kontraktues se OE ankues I.T.K"Shpk nuk e plotëson kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional për pajisjet e kërkuara ku sipas këtij vendimi të AK-së,OE ankues ka ofertuar në 6 lot, mirëpo pajisjet i ka ofruar vetëm për tri lloje dhe sipas AK-së,ky OE është shpërblyer me kontratë për tri lloje në këtë aktivitet të prokurimit,eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH. nr 455-464/18 të datës 05.10.2018.

OE ankues I.T.K"Shpk në ankesën e tij nuk ka dhënë ndonjë arsyetim lidhur me pajisjet e ofruara apo edhe kundërshtimet me arsyet e eliminimit të ofertës së tyre nga ana e AK-së por vetëm ka bërë një përshkrim të kronologjisë së këtij aktiviteti të prokurimit duke theksuar se oferta e tyre është më e lirë. Konsideroj që ky pretendim është i gjykuar në vendimin e OSHP-së dhe është i pa bazuar.

**PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË GRUPIT TË OE ANKUES
"DOREARTI"SHPK.; "BENI COM" SHPK; "LINDI MARKINGS"SHPK**

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimin e grupit të OE“Dorearti”Shpk; “Beni-com” Shpk ; “Lindi Markings”Shpk,se AK gjatë procesit të rivlerësimit ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se nuk plotëson kërkesën e kapacitetit ekonomik dhe financiar të dosjes së tenderit,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosjen e tenderit është kërkuar që OE duhet të ketë kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (Mjete të gatshme në xhirollogari nga kompania në bankë në vlerë prej së paku 100,000.00 €, ose qasje në kredi nga një bankë), e dëshmuar me deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi të pakushtëzuar, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar.

Grupi i OE“Dorearti”Shpk;”Beni com“Shpk ; “Lindi Markings”Shpk ka dorëzuar një Letër Referencë të ProCredit Bank duke specifikuar se ProCredit Bank do të konsideroj mbështetjen financiare duke u bazuar në kapacitetin e tij financiar dhe nëse plotësohen kushtet e përcaktuara nga Banka për financimin në fjalë.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së,PSH.nr 181-182-191/19 të datës 19.06.2019,citoj një pjesë të vendimit”Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton lidhur me letër përkrahjen nga bankat për OE në fjalë se në lëndën e AK gjenden shkresat e lëshuara nga Procredit Bank me datën 11.06.2018,në të cilat dëshmohet gjendja e llogarisë bankare e OE “Dorearti” në vlerë mbi 100,000.00 € (mbi Njëqindmijë euro),të cilat shkresa grupi i OE ankues i ka dorëzuar në AK,pas kërkesës së AK që grupi i OE ankues konform nenit 72 të LPP-së,të dorëzoj dëshmi shtesë për ta sqaruar përkrahjen nga banka lidhur mjetet e gatshme në vlerë prej 100,000.00 €.Pretendimi ankimor është i bazuar

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Lidhur me pretendimin e grupit të OE“Dorearti”Shpk; “Beni com“ Shpk ; “Lindi Markings” Shpk,se AK gjatë procesit të rivlerësimit ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se nuk plotëson kërkesën 3. të kapacitetit teknik dhe profesional, ku është kërkuar lista e kontratave të realizuara jo më pak se 500,00.00 € në tri vitet e fundit të lëmisë së kërkuar që sipas OE ankues kontratat dhe referencat e prezantuara e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH.nr 181-182-191/19 të datës 19.06.2019,citoj një pjesë të vendimit Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i bazuar për faktin se grupi i OE ankues se bashku me dosjen e tenderit kanë dorëzuar lista të projekteve të realizuara të lëmisë së kërkuar në periudhën e shkuar tre vjeçare (2014,2015 dhe 2016) të shoqëruara me kontrata dhe referenca/raporte të pranimit teknik konform kërkesës

dhe dëshmisë së parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit si vijon : lista e kontratave të realizuara jo më pak se 500.000.00 € të lëmisë së kërkuar në periudhën e shkuar tre vjeçare (2014, 2015 dhe 2016). Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e kërkuar (Sinjalizim horizontal dhe Vertikal, Pahi Elastike, Mirëmbajtja e Ndriçimit rrugor, Mirëmbajtja e Semaforëve, Mirëmbajtja e Numëruesve të Trafikut).

Eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim është gjykuar më parë nga OSHP dhe pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se AK ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se pajisjet e ofruara nuk janë konform kërkesës së kapacitetit teknik dhe profesional dhe specifikimit teknik në dosje të tenderit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të ofrojnë dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapaciteteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit), e noterizuar ose origjinal. OE duhet të sjell dëshmi (specifikimin për pajisjen) për pajisjet, të cilat ka ndërmend t'i angazhoj për këtë projekt (pajisjet duhet të verifikohen nga noteri sipas procedurës së verifikimit të pajisjeve).

Grupi i OE "Dorearti" Shpk; "Beni com" Shpk ; "Lindi Markings" Shpk ka dorëzuar një raport për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike, dy certifikata të regjistrimit të automjetit dhe një dokument unik doganor me nr IE0283639D për pajisjen makinë për shënimin e vijave në asfalt.

Dokumenti unik doganor është në emër të N.P.T "Noli" Xërxë, Rahovec dhe OE ankues nuk ka ofruar ndonjë dëshmi që kjo pajisje është në pronësi të saj apo ndonjë dëshmi të blerjes apo marrjes me qira siç është kërkuar në dosje të tenderit. Gjithsesi AK konform nenit 72 të LPP-së ka mundur të kërkoj sqarime apo dokumente shtesë nga OE për këtë pajisje.

Oferta e grupit të OE "Dorearti" Shpk; "Beni com" Shpk ; "Lindi Markings" Shpk AK nga është shpallur e përgjegjshme përfshirë këtu edhe çështjen e pajisjeve por është vlerësuar si ofertë më e shtrenjtë dhe nuk është rekomanduar për kontratë siç është rasti i vendimit të AK nr. ZP 36/2018 të datës 02.07.2018

Pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar

Përgjigje në Pretendimi nr. 4

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "Dorearti" Shpk; "Beni com" Shpk ; "Lindi Markings" Shpk- se AK

ka anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me vendimet paraprahe të OSHP-së, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues (B58) të datës 31.08.2020, AK njofton se anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se të gjitha ofertat e pranuar janë të papërgjegjshme duke sqaruar në letrat standarde për tenderuesit e eliminuar se vlerësimi i ofertave është bërë duke u bazuar në dosjen e tenderit, jo të formularit B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara për arsye se nuk është korrigjuar dosja e tenderit. Me datë 01.08.2017 është publikuar njoftimi për kontratë, ndërsa me datë 21.08.2017; 31.08.2017; 04.09.2017; 07.09.2017 dhe 11.04.2018 është bërë korrigjimi i njoftimit për kontratë, mirëpo dosja e tenderit nuk është korrigjuar asnjëherë.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH.nr.906-907-922-925-926/20 të datës 30.01.2020, citoj një pjesë të vendimit “Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton se AK me datën 01.08.2017 ka publikuar njoftimin për kontratë, ndërsa me datat: 21.08.2017 , 31.08.2017, 04.09.2017 dhe 07.09.2017 përmes “Formularit standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara B54” ka bërë korrigjimin e njoftimeve të publikuara (njoftimi për kontratë dhe dosjes së tenderit), andaj bazuar në pikën 47.11 të RRUOPP, sqarimin e KRPP-së të datës 11.04.2019 si dhe praktikat e prokurimit publik dokumentet në fjalë konsiderohen pjesë e dosjes së tenderit si dhe të njëjtat dokumente respektivisht pjesët e korrigjuara të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit me këto dokumente, duhet të merren për bazë nga AK me rastin e vlerësimit të ofertave, e jo të konsiderohen dokumente të ndryshme nga dosja e tenderit, Konsideroj qe pretendimi ankimor është i bazuar

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES “SELECT PRIMA” SHPK

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimin e OE “Select Prima” Shpk, se AK gjatë rivlerësimit pa të drejte ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se ka ofruar çmime me më shumë se dy numra pas presjes dhjetore që konform Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, paragrafit 18.3, çdo numër i shënuar pas numrit të dytë (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës dhe rrjedhimisht çmimet e ofruara janë me vlerë 0.00, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

AK duke u thirrur në Rregulloren dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik, paragrafi 41.15 me datë 21.08.2020 përmes Letrës Standarde për sqarimin e tenderit ka kërkuar nga OE “Select Prima” Shpk të shpjegoj çmimet e ofruara me 0.00 €.

Me datë 21.08.2020 OE "Select Prima" Shpk ka sqaruar se nuk kanë ofruar çmime me 0.00 €,por kanë ofruar çmim me 0.001 €,ndërsa referimi i AK-së për nenin 41.15 të RROPP-së për OE ankues nuk është i saktë dhe nuk ka të bëjë me këtë rast.

Eksperti shqyrtues konstaton se arsyetimi i OE ankues "Select Prima" Shpk është i bazuar ngase ky OE nuk ka ofruar çmim me vlerë prej 0.00,ndërsa neni 41.15 i RRUOPP-së ndërlidhet me rastet kur ofrohet çmimi prej 0.00 €.Pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Lidhur me pretendimin e grupit të OE Select Prima" Shpk, se AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me vendimet paraprake të OSHP-së, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues (B58) të datës 31.08.2020,AK njofton se anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se të gjitha ofertat e pranuar janë të papërgjegjshme duke sqaruar në letrat standarde për tenderuesit e eliminuar se vlerësimi i ofertave është bërë duke u bazuar në dosjen e tenderit, jo të formularit B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara për arsye se nuk është korrigjuar dosja e tenderit. Me datë 01.08.2017 është publikuar njoftimi për kontratë, ndërsa me datë 21.08.2017;31.08.2017;04.09.2017;07.09.2017 dhe 11.04.2018 është bërë korrigjimi i njoftimit për kontratë, mirëpo dosja e tenderit nuk është korrigjuar asnjëherë.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH. nr. 906-907-922-925-926/20 të datës 30.01.2020,citoj një pjesë të vendimit "Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton se AK me datën 01.08.2017 ka publikuar njoftimin për kontratë, ndërsa me datat: 21.08.2017 , 31.08.2017,04.09.2017 dhe 07.09.2017 përmes "Formularit standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara B54" ka bërë korrigjimin e njoftimeve të publikuara (njoftimi për kontratë dhe dosjes së tenderit),andaj bazuar në pikën 47.11 të RRUOPP, sqarimin e KRPP-së të datës 11.04.2019 si dhe praktikat e prokurimit publik dokumentet në fjalë konsiderohen pjesë e dosjes së tenderit si dhe të njejtat dokumente respektivisht pjesët e korrigjuara të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit me këto dokumente, duhet të merren për bazë nga AK me rastin e vlerësimit të ofertave, e jo të konsiderohen dokumente të ndryshme nga dosja e tenderit" Konsideroj qe pretendimi ankimor është i bazuar

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "RSM COMPANY" SHPK

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE "RSM Company" Shpk, se AK gjatë rivlerësimit ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se nuk ka ofruar dëshmi për pajisjen nr 2 konform kërkesës së dosjes së tenderi, eksperti shqyrtues se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-se,PSH. nr 181-182-191/19 të datës 19.06.2019,citoj një pjesë të vendimit "Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton se në ofertën e OE ankues "RSM COMPANY"SHPK gjenden listat e pajisjeve për secilin Lot veç e veç ku vlen të ceket se këto lista kanë përshkrim të njëjte për llojin e pajisjes për LOT 1 deri ne LOT 6. Po ashtu këtyre listave i janë bashkangjitur kopjet e dokumenteve të pajisjeve të vërtetuara tek noteri z. Zylefer Aliu. Andaj autoriteti kontraktues me të njëjtat dokumente ka shpallur fitues OE në fjalë për LOT 5,ndërsa për LOT 2 dhe 3 e eliminon nga ky aktivitet i prokurimit përkundër që në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit janë parashtruar kërkesat dhe dëshmitë e njehta si për LOT 5 ashtu edhe për LOT 2 dhe 3,me çka nënkuptohet se autoriteti kontraktues nuk e ka trajtuar barabartë ofertën e OE ankues në këtë aktivitet të prokurimit për LOT-et veç e veç. Eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim është trajtuar dhe pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin tjetër të OE "RSM Company"Shpk se oferta e tyre është eliminuar me arsyetimin se nuk ka ofruar një deklaratë me shkrim e cila do të përfshinte një zbërthim të pjesëve relevante të tenderit konform nenit 61 të LPP-së Tenderët Jo-Normalisht të Ulët dhe Rregullat për tenderët Jo-Normalisht të Ulët, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Me datë 21.08.2020,AK përmes Letrës standarde për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët ka kërkuar nga OE "RSM Company" Shpk që të jep një shpjegim detal të elementeve përbërëse të tenderit lidhur me disa çmime të cilat nuk korrespondojnë më çmimet e tregut.

Me datë 30.09.2020,eksperti shqyrtues përmes e-mailit ka kërkuar nga OE "RSM Company" Shpk nëse i është përgjigjur kërkesës së AK-së për sqarime të elementeve të tenderit.

Në të njëjtën datë nga OE "RSM Company" Shpk kam pranuar sqarime se me datë 24.08.2020 kanë dërguar tek zyrtari i AK-së dokumentin me sqarime për elementet e tenderit.

OE "RSM Company" Shpk në dokumentin e dërguar ka sqaruar për të gjitha pozicionet e kërkuara duke kalkuluar kostot për secilin pozicion/element të tenderit duke ja bashkangjitur dhe faturat e furnizuesve dhe dudadat doganore të materialeve.

Për ekspertin shqyrtues është i paqartë arsyetimi i AK-së se OE nuk ka ofruar dëshmi sipas kërkesës apo cila nga sqarimet është në kundërshtim me kërkesën e AK-së. Pretendimi ankimor është i bazuar

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Sa i përket pretendimit tjetër se dosja për Inxhinierin e Ndërtimtarisë-Drejtimi Konstruktiv z Sefedin Shala nuk është konform kërkesës së dosjes së tenderit, eksperti shqyrtues së ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH. nr. 15-169-173/18 të datës 05.06.2018 në të cilin pretendimi ankimor i OE ankues është gjykuar si i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.4

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "RSM Company" Shpk, se AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me vendimet paraprake të OSHP-së, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues (B58) të datës 31.08.2020, AK njofton se anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se të gjitha ofertat e pranuar janë të papërgjegjshme duke sqaruar në letrat standarde për tenderuesit e eliminuar se vlerësimi i ofertave është bërë duke u bazuar në dosjen e tenderit, jo të formularit B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara për arsye se nuk është korrigjuar dosja e tenderit. Me datë 01.08.2017 është publikuar njoftimi për kontratë, ndërsa me datë 21.08.2017;31.08.2017;04.09.2017;07.09.2017 dhe 11.04.2018 është bërë korrigjimi i njoftimit për kontratë, mirëpo dosja e tenderit nuk është korrigjuar asnjëherë.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH. nr. 906-907-922-925-926/20 të datës 30.01.2020, citoj një pjesë të vendimit "Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton se AK me datën 01.08.2017 ka publikuar njoftimin për kontratë, ndërsa me datat: 21.08.2017 , 31.08.2017,04.09.2017 dhe 07.09.2017 përmes "Formularit standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara B54" ka bërë korrigjimin e njoftimeve të publikuara (njoftimi për kontratë dhe dosjes së tenderit), andaj bazuar në pikën 47.11 të RRUOPP, sqarimin e KRPP-së të datës 11.04.2019 si dhe praktikat e prokurimit publik dokumentet në fjalë konsiderohen pjesë e dosjes së tenderit si dhe të njejtat dokumente respektivisht pjesët e korrigjuara të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit me këto dokumente, duhet të merren për bazë nga AK me rastin e vlerësimit të ofertave, e jo të konsiderohen dokumente të ndryshme nga dosja e tenderit" Konsideroj qe pretendimi ankimor është i bazuar

**PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË GRUPIT TË OE ANKUES
"TSR"SHPK;"IDK KONSTRUKSION" ;"2T"**

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e grupit të OE TSR "Shpk &"IDK Konstruktion" & "2T" (ish Sinjal RKS-Shpk),se

AK gjatë procesit të rivlerësimit ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se nuk plotëson kërkesën 3. të kapacitetit teknik dhe profesional, ku është kërkuar lista e kontratave të realizuara jo më pak se 500,00.00 € në tri vitet e fundit të lëmisë së kërkuar që sipas OE ankues kontratat dhe referencat e prezantuara e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosjen e tenderit është kërkuar që OE të dorëzojnë listën e kontratave të realizuara jo më pak se 500.000.00 € të lëmisë së kërkuar në periudhën e shkuar tre vjeçare (2014, 2015 dhe 2016). Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e kërkuar (Sinjalizim horizontal dhe Vertikal, Pahi Elastike, Mirëmbajtja e Ndriçimit rrugor, Mirëmbajtja e Semaforëve, Mirëmbajtja e Numëruesve të Trafikut)

Grupi i OE TSR"Shpk &"IDK Konstruktion" & "2T" (ish Sinjal RKS-Shpk) se bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar listat e kontratave për dy anëtarët e konzorciumit, eksperti shqyrtues më poshtë po e liston vetëm një kontratë e cila e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit.

-Kontrata në mes të Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe OE "IDK Konstruktion", e lidhur me datë 31.12.2014 për "Përmirësimin e sigurisë dhe i sinjalistikës rrugore në superstradën Tiranë-Durrës dhe segmentin rrugor Kashar-Rinas Loti 2 " në vlerë prej 295,101,639.00 lekë apo 2,459,180,325.00 €.

Gjithashtu është i bashkangjitur edhe Raporti i pranimit sipas të cilit punimet janë realizuar në shumë prej 295,097,534.00 lekë me datë 03.09.2015.

Nga kjo shumë OE "IDK Konstruktion ka kryer 60% të punimeve të kontratës ndërsa nënkontraktori "Madenkost"Shpk ka realizuar 40% të kontratës.

Eksperti shqyrtues konstaton se kjo kontratë është konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe përmbush vlerën e kërkuar prej 500,000.00 €. Pretendimi ankimor është i bazuar

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin e grupit të OE TSR"Shpk &"IDK Konstruktion" & "2T" (ish Sinjal RKS-Shpk),se AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me vendimet paraprake të OSHP-së, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues (B58) të datës 31.08.2020,AK njofton se anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se të gjitha ofertat e pranuar janë të papërgjegjshme duke sqaruar në letrat standarde për tenderuesit e eliminuar se vlerësimi i ofertave është bërë duke u bazuar në dosjen e tenderit, jo të formularit B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara për arsye se nuk është korrigjuar dosja e tenderit. Me datë 01.08.2017 është publikuar njoftimi për kontratë,

ndërsa me datë 21.08.2017;31.08.2017;04.09.2017;07.09.2017 dhe 11.04.2018 është bërë korrigjimi i njoftimit për kontratë, mirëpo dosja e tenderit nuk është korrigjuar asnjëherë.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH. nr. 906-907-922-925-926/20 të datës 30.01.2020,citoj një pjesë të vendimit “Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton se AK me datën 01.08.2017 ka publikuar njoftimin për kontratë, ndërsa me datat: 21.08.2017 , 31.08.2017,04.09.2017 dhe 07.09.2017 përmes “Formularit standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara B54” ka bërë korrigjimin e njoftimeve të publikuara (njoftimi për kontratë dhe dosjes së tenderit),andaj bazuar në pikën 47.11 të RRUOPP, sqarimin e KRPP-së të datës 11.04.2019 si dhe praktikat e prokurimit publik dokumentet në fjalë konsiderohen pjesë e dosjes së tenderit si dhe të njejtat dokumente respektivisht pjesët e korrigjuara të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit me këto dokumente, duhet të merren për bazë nga AK me rastin e vlerësimit të ofertave, e jo të konsiderohen dokumente të ndryshme nga dosja e tenderit” Konsideroj qe pretendimi ankimor është i bazuar

Eksperti shqyrtues konstaton se AK nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave konform nenit 59 të LPP-së dhe vendimeve dhe urdhëresave të OSHP-së, andaj rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të **aprovohen pjesërisht si të bazuara**, të anulohet njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në **Rivlerësim**.

Autoriteti Kontraktues me datë: 09.10.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se Nuk Pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Panelin shqyrtues duke shpresuar qe ta lexoni deri ne fund dhe ketë here te meni një vendimi Ligjore duke mos u bazuar ne mendimet e ekspertit i cili me ketë ekspertizë ju ka ve ne lajthitje.

Me poshtë mund ti gjeni te gjitha faktet dhe argumentet për mospajtim me mendimin e ekspertit:

- **Pajtohem me mendimin e ekspertit vetëm me ekspertizën e ekspertit për I.T.K Sh. P. K**
- Nuk pajtohem me mendimin e ekspertit për ekspertizën e ekspertit për Operatorin Ekonomik “Dorearti Sh. P. K” & “Beni Com Sh. P. K” & “Lindi Marking Sh. P. K” me poshtë gjeni faktet dhe argumentet:

- a) Në dosjen e tenderit tek Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare: Kërkesa 2: Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (Mjete të gatshme në xhirollogari nga kompania në bankë në vlerë prej së paku 100,000.00 €, ose qasje në kredi nga një bankë). Evidenca 2: Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi të pakushtëzuar, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar. OE i është lëshuar mbështetja bankare e kushtëzuar (do të shqyrtohet), jo e pakushtëzuar siç është kërkuar.

Përgjigje:

Ne baze të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 59 dhe 72; Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik Neni 39 ceket saktësisht: Autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë

E në këtë rast nuk e kuptoj se për çfarë arsye duhet të kërkohet informacione kur çdo gjë është e qartë, është kërkuar qasje në kredi të pakushtëzuar, ndërsa OE ka ofruar dokumentin nga banka në të cilin ceket se kredia do të shqyrtohet.

- b) Në dosjen e tenderit tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar: Kërkesa 3, për Llot I-VII, dhe Llot VIII: Lista e kontratave të realizuara jo më pak se 500.000.00 € të lëmisë së kërkuar në periudhën e shkuar tre vjeçare (2014, 2015 dhe 2016). Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e kërkuar (Sinjalizim horizontal dhe Vertikal, Pahi Elastike, Mirëmbajtja e Ndriçimit rrugor, Mirëmbajtja e Semaforëve, Mirëmbajtja e Numëruesve të Trafikut). Evidenca 3, për Llot I - VII: Kopje të kontratave që vërtetojnë realizimin e punëve në lëmin e sinjalizimit për tri vitet e fundit (2014, 2015, dhe 2016) duke bashkëngjitur: referencat për vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve në lëmin e kërkuar Sinjalizim horizontal dhe Vertikal, Pahi Elastike). Evidenca 3, për Llot VIII: Kopje të kontratave që vërtetojnë realizimin e punëve në lëmin e mirëmbajtjes së semaforëve, mirëmbajtjen e ndriçimit të rrugëve dhe mirëmbajtjen dhe servisimin e numëruesve automatik të rrugëve, në tri vitet e fundit duke bashkëngjitur (2014, 2015, dhe 2016): referencat për vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve në lëmin e kërkuar, ndërsa OE nuk ka prezantuar projekte në lamine të kërkuar sipas krekës se FDT-se në vlerë 500.000.00 € por ka prezantuar disa pozicione të kryera në projekte të ndërtimit të rrugëve.

Pergjigje:

Ne baze te asaj qe u cek me larte eshte kjart e kerkuar lista e projekteve te realizuara, jo pozicionet ne projekt te realizuara.

- c) Janë kërkuar dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapaciteteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit), e noterizuar ose origjinal. OE duhet të sjell dëshmi (specifikimin për pajisjen) për pajisjet, të cilat ka ndërmend t'i angazhoj për këtë projekt (pajisjet duhet të verifikohen nga noteri sipas procedurës së verifikimit të pajisjeve) Sasia e kërkuar ka qene 1 copë për Lot, ndërsa operatori ekonomik nuk ka ofruar kontratën për huazim për pajisjet me nr. Rendor 1, 2 dhe 3 i ka të prezantuara me dud doganar me nr. IE0283630D në emër të N.P.T Noli Xërxë Rahovec”

Pergjigje:

Ne baze te Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 59 dhe 72; Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik Neni 39 ceket saktësisht: Autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë

E në këtë rast nuk e kuptoj se për çfarë arsye duhet të kërkohet informacione kur Operatori nuk ka sjell as një dëshmi për marrvëshjen, gjithsesi vlen të theksohet se në Nenin 72 të LPP ceket **autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë**, është e drejtë e autoritetit kontraktues të shfrytëzohet apo mos të shfrytëzohet.

d) Sqarim:

Vlerësimi i ofertës është bërë duke u bazuar në dosje të tenderit, jo të formularit B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara për arsye se nuk është korrigjuar dosja e tenderit

Me datë 01.08.2017 është publikuar njoftimi për kontratë, ndërsa me datë 21.08.2017, 31.08.2017, 04.09.2017, 07.09.2017 dhe 11.04.2018 është bërë korrigjimi i njoftimit për kontratë mirëpo dosja e tenderi nuk është korrigjuar as një herë.

Në korrigjimin e datës 04.09.2019 i cili ka pas me se shumti ndryshime tek NJOFTIM PER INFORMATA SHITESE ose PERMIRESIM I GABIMIT Neni IV.2.3 Teksti i cili duhet të përmirësohet/shtohet në njoftimin origjinal (nëse aplikohet) cekte:

Vendi i tekstit i cili duhet të modifikohet:	Në vend të:	Është :
---	--------------------	----------------

Autoriteti kontraktues tek “ne vend te” “është” ka kërkuar kërkesa te njëjta dhe te dyfishta vlen te theksohet kërkesa nr. 5 tek kolona është kërkuar dy here dhe atë e ndryshme.

“Kërkesa 5: Mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e punëve në pronësi ose marrëveshje për furnizim me një operator ekonomik i cili ka kapacitetet e nevojshme siç është cekur në specifikimin teknik në dokumentacionin e tenderit” dhe

“Evidenca 5: Dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapaciteteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit), e noterizuar ose origjinal. OE duhet të sjell dëshmi (specifikimin për pajisjen) për pajisjet, të cilat ka ndërmend t'i angazhoj për këtë projekt (pajisjet duhet të verifikohen nga noteri sipas procedurës se verifikimit të pajisjeve)”

Ne baze të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregullores Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik dosje e tenderi dhe njoftimi për kontratë duhet te jene te njëjta.

Tek përshkrimi i çmimeve Sasia e artikujve është 1, ndërsa me date 07.09.2017 është shtuar një dokument i emërtuar si “specifikimi teknike, ndryshime e bëra me date 05.09.2019”.

Ne këtë dokument janë ndryshuar specifikat teknike dhe është vendosur sasia indikativë, sipas Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregullores Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik ndryshimi i dosjes B54 - Formulari për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara, gjithashtu vlen te theksohet se dokumenti i publikuar me date 07.09.2019 ka mos përputhje me dosjen e tenderit.

Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregullores Udhëzuesit Operativ qe nga 2015 për kontrata kornizë Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë derivim prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%). pa

Edhe sa i përket konstatimeve në lidhje me operatorin ekonomik **Dorearti Shpk&Beni com shpk&Lindi Markings shpk** nuk pajtohem me mendimin e ekspertit të OSHP-së, sepse i njëjti operator ekonomik me të drejtë është shpallur i papërgjegjshëm, ndërsa nga ana e ekspertit nuk është konstatuar sakt një gjë e tillë dhe i është lënë hapësirë për sqarime për çështje të cilat janë të qarta dhe që nuk ka nevojë për sqarime, fjala është për pajisjen e vijave me asfalt e për të cilën nuk është ofruar asnjë dëshmi se është në pronësi të tyre, e as të NPT Noli, prandaj ti krijohet hapësirë për sqarime pas gjithë këtyre rivlerësime është absurde, prandaj eksperti është dashur të konstatojë sakt se nuk e ka këtë pajisje sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

I njëjti operator ekonomik është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e ka plotësuar kërkesën në lidhje me kapacitetin teknik profesional, në lidhje me kontratat dhe referencat në vlerë prej 500 mijë euro në lëminë e kërkuar, prandaj edhe ky operator ekonomik është dashur qysh në start në vlerësimin e parë të

shpallej operator ekonomik i papërgjegjshëm dhe jo ti krijohej hapësirë mbi dy vite që të bëjë ankesa të pabaza edhe pse vetë ka qenë palë pa interes në këtë aktivitet të prokurimit konform nenit 11 lparagrafi 1.5-1.8 të LPP-së përkitazi me nenin 4.1.26 të LPP-së.

I njëjti operator ekonomik raportin për mjetet e ka të nënshkruar dhe vulosur vetëm nga kompania por nuk e ka të noterizuar, ndërsa në lidhje me këtë kërkesë AK-ja në mënyrë të kundërligjshme kishte kërkuar sqarime shtesë dhe i njëjti OE më pastaj e ka ofruar listën e pajisjeve të noterizuar **e cila niban datën pas datës së hapjes të ofertave** e që ky fakt bie në kundërshtim me nenin 72.3 të LPP-së.

Ndërsa ky fakt është cekur edhe në njërin nga raportet e rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit.

I njëjti operator ekonomik një pajisje - Kombi Bus ka deklaruar se kjo pajisje mbulon pajisjet e kërkuar për disa lote, edhe pse për secilin lot është kërkuar pajisje e veçantë.

Prandaj, në fund kërkojmë nga paneli shqyrtues që të aprovojë ankesën tonë si të bazuar, të konstatojë papërgjegjshmërinë e OE **ITK, Rsm Company, TSR Shpk&IDK Konstruksion&2T, Dorearti Shpk&Beni coin shpk&Lindi Markings shpk** dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Operatori Ekonomik "RSM COMPANY" SHPK, me datë: 02.10.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se Pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik "TSR" SHPK (ISH SINJAL SHPK), me datë: 02.10.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se Pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

PERGJIGJE ne lidhej me pajtimin apo jo te mendimin e ekspertit sa i **përket ankesës** me nr , 632 648 674 691 700/20.

Sa i perket mendimit te ekspertit me rastin e ankeses pran OSHP me nr 632 648 674 691 700/20 ne emer te koncersjunit Sinjal (Riemruar TSR-Shpk)IDK -2T pergjiegjemi si vijon :

1. Sa i përket lidhur me pretendimin e ekspertit sa i përket ankese se koncercjunit ton drejtuar Oshp dhe sqarimin e ekspertit sa i përket pretendimit ton dhe dëshmime tona kundër pretendimit te AK per arsyen e eliminimit ,ku ne ket rast Eksperti shqyrtues ankesën ton e cilson si te bazuar ne pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues pasiqe faktet dhe deshmit kanë qen te tilla qe ankesa e jon te cilësohet si e tillë (E Bazuar)
2. Ne nuk pajtohemi me pretendimet e ekspertit shqyrtues sa i përket sqarimeve te dëshmime qe i bën

ndaj OE tjerë ankues duke filluar nga OE Ankues Dorarti Beni com Shpk si dhe as me sqarimet te dëshmime ndaj OE RSM Compani Shpk,dhe OE Selekt Prima. Pse ne Ngritim këto pretendime e sqarojmë një nga një me poshtë;

3.Sa i përket sqarimit te ekspertit shqyrtues për pretendimet e AK ngritur me mangësi e OE **Dorarti Beni com Shpk** Mendojmë qe eksperti shqyrtues i kësaj lënde nuk esht marr mjaftueshëm me këto fakte dhe ka lend hapsir te mjaftshme per keqinterpretime pse mendojmë Kështu, pik se pari eksperti shqyrtues e keqinterpreton kërkesën e DT tek pika 9.1 dhe 9.2 tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ku thotë se sa i përket pretendimeve te AK dhe sqarimit te pretendimit nr 3 te ekspertit shqyrtues citojm;

Grupi i OE "Dorarti" Shpk: "Beni com" Shpk : "Lindi Markings" Shpk ka dorëzuar një raport permjetet.stabilimentet dhe pajisjet teknike. dy çertifikata të regjistrimit të automjet. dhe një dokument unik doganor me nr IE0283639D për pajisjen makinë për shënim e vijave ne asfalt Dokumemi unik doganor është ne emer N.P.T "Noli- Xërxë.Rahovec dhe OE. ankues nuk ka ofruar ndonjë dëshmi që kjo pajisje është në pronësi të saj apo ndonjë dëshmi të blerjes apo marrjes me qera SIQ eshte kërkuar në dosje të tenderit. Gjithsesi AK konform nenit 72 të LPP-së ka mundur të kërkoj sqarime apo dokumente shitesë nga OE për këtë pajisje.

Me ket rast Eksperti shqyrtues e keqinterpreton nenet e LPP pasi qe rastet kur interpretohet neni 72 i LPP dhe neni 59 i LPP i kemi te sqaruara shumë kuart ne ligjin e RRUPIT NENI 39.8 Ku ceket problemi, si te veprohet dhe njekosisht sipas cilit nen duhet vepruar andaj sipas DT me vet faktin qe ne ketë rast OE ekonomik sjell një dëshmi qe me nje pozicion 1-2-3 dhe te cilat nuk i ka te motorizuara tek noteri dhe sipas ekspertit shqyrtues ne ket rast se AK ka mundur te kerkoj sqarime shitesë, Ktu Eksperti shqyrtues bën keqinterpretim te keti neni pasi qe Neni 68 i LPP e lejon AK qe te kerkon informata sqaruese vetem ne rast se mungon nje dëshmi, mirpo ne ket rast OE ekonomik i ka ofruar dëshmit siq jan dëshmit e pa notorizuara dhe dudin doganor ne kmer te një firme me te cilen as nuk ka bashpunim as dukoment shitblerje e me ket rast Neni 68 LPP thotë shumë kuart Refuzo tenderin pa kerkuar informacion te matutjeshem, ndersa sipas interpretimit te Ekspertit shqyrtues i epet mundësija keti OE qe te bej manovrime(Ndoshta te sjell dukoment shitblerje kinse kjo ka ndodhur para hapjes se tenderit me shitësin Noli Xërxë e cila me vonë nuk do te mund te vërtetohet vertetesija e saj) dhe te sjell dukomente me te mëvonshme siç ka veprua me mbështetjen Bankare ku sjell dëshmi mbas 2 viteve se i ka ne Xhirollogari 100.000,00 ndërsa ne rastin e hapjes se tenderit si ka pasur, mirpo me dhenjen e mundesis për manipulime sot ky OE e plotson ket kusht dhe thirret ne vendimet e OSHP qe e plotson ket kusht, Andaj sipas mendimit ton Ktu eksperti ka lend mundsi manipulimi duke keqinterpretuar nenet e LPP

pasiqe neni 68 thot ne menyre te kjar deshmimit mbi gjendjen ekonomike financiare nuk permbushin kerkesat minimale refuzo tenderin pa kerku informacion te metutjeshem.

3.Sa i perket sqarimti te ekspertit shqyrtues per pretendimet e AK ngjritur me mangesit e OE **RSM Compani** se a jan te verteta apo jo ne nuk pajtohemi me vendimimin e tij pasiqe siq vrehet qart ky nuk e merr mundin fare qe te vertetoj faktet se a jan te verteta apo jo vetem thirret ne nje vendim te OSHP pa i shushitur faktet. Sa i perket fakteve te stabilimenteve ku kerkohet sjellet deshmi sips DT, e keto deshmi do te duhej te sjelleshin ose te noterizuara ose origjinale, ktu deshmimit te cilat eksperti shqyrtues nuk i shikon dhe nuk e shqyrton me kujdes bjeje deri tek vendimi i ti qe keto deshmi qe sipas neve jan te pa pergjegjeshme me nje vendim te ekspertit dhe me von ndoshta te OSHP pasiqe nuk shoshiten te behen vendime te bazuara dhe te Plotfuqishme e ku me vonë OE thirret ne vendime te OSHP se jan shqyrtuar kto vendime,Lind pyetja se pse ne e hedhim poshtë këtë vendim te Ekspertit dhe e kontestojmë ne kemi dëshmi qe ky OE ka sjell dukoment te noterizuar nga notari për mjetet dhe stabilimentet te cilat nuk do te ishin valide nga fillimi dhe nuk do te duhej te shpërblehet edhe me as një kontratë sepse shiko deshmin posht ku thotë notari vërteton dukomentin kopje ne Original Qe do te thot se ky notar nuk i notorizon makineritë por notorizon vetëm vertetimin e dukomentit nga ORIGINALI NE Kopje Deshmija] e cila esht identike për te gjitha Llotot(Duke filluar nga llotot 1 deri 8) e ofruara nga ky OE.

Siç shihet ne deshmin me lar Noteri konfirmon se ky vërteton vetëm dukomentin e quajtur pajisjet teknike duke filluar nga llotete 1 deri ne 8 dhe me poshtë thotë se noteri nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen e dukomentit qe asht sjell ne zyrën e tij dhe me këtë fakt e vërteton se ky notorizon një dukoment origjinal ne një kopje dhe jo edhe pajisjet me numër rendor qe gjenden ne te pasiqe thotë ne menyre Sham te kjar se noteri nuk mban pergjegjesi dhe nuk e vërteton përmbajtjen e dukomentit e ne rastin ton kërkohe qe te vërtetohet përmbajtja e dukomentit (ne te cilën gjendet makineritë dhe pajisjet sipas kërkesës se DT) , qka kupton nje notar me këtë fakt qe dukomenti mund te përmbaj edhe te pa vërteta por ne e notorizojm vetem origjinalin ne kopje dhe sa i përket përmbajtjes se ti OE mund te shkruaj qfar te dojë dhe se aj duhet te jap përgjegjësi për përmbajtjen e dukomentit .Andaj ne çuditemi me vendimin e ekspertit shqyrtues se si nuk e vren ket fakt po e len këtë ket OE me këto dëshmi te përgjegjshëm e me KON ky OE kto dëshmi i përdor me vendime te OSHP edhe pse sjan te vërteta pasiqe sjan shoshit mirë thotë asht vendos nga OSHP

Pos kesj ne qoft se do ti kishte vetetuar pajisjet teknike do te duhej qe ti vertetoj edhe dukomenta tpercjellese te cilat do te duhej te ja bashkangjiteve DT siq jan kontrata e shitblerjes kontrata ehuazimit me librezat e automjeteve , dudat doganor e dukomenta te tjera dhe keto duke filluar Me paisjet teknike per llot 1 deri me paisjet teknike per Llot 6 tek pozicjoni paisjet teknike per lot 1 pozicjoni 3-4-5 i kemi te njehta si tek pozicjoni si tek paisjet teknike tek Lloti2 Pozicjoni 3-4-5 Lloti 3 pozicjoni 12-13-14 Lloti 4 Pozicjoni 21-22-

23 Lloti 5 Deshmit pozicjoni 30-31-32 Lloti 6 Pozicjoni 39-40-41 (deshmit nga dukumentat Lloti 1 Deri deshmite Lloti 6 ja bashkangjitem kesaj shkrese dhe jan Ne atashment) Po ashtu per qudin ton quditemi se si eksperti pretendimin e keti OE e len te bazuar kur i njehti OE e ka te njeten makin per sinjalizim horizontal (Paisjet teknike per llot 3 pozicjoni 10 Deshmija 3 dhe paisjet teknike per Lotin 5 pozicjoni 28 Deshmija 5) Pastaj na qudit fakti se perseri eksperti i prokurimit nuk e vren faktin se ky OE tek Paisjet teknike per lloti 3 Tek pozicjoni 10 esht identik Me listen tek paisjet teknike per llotin 5 pozicjoni 29

Andaj ne pos qe e kontestojm ne tersi listat e notorezura Kinse lista e makinerive sipas kerkeses se DT te cilat sjan noterizuar fare po asht noterizuar vetem dukumenti nga origjinali ne kopje dhe ku notari thot qart se per permbajtjen e listes nuk merr pergjegjesi qe do te thot makinerit si notorizon fare dhe eksperti nuk ka vreitje e as qe merret me ket qeshtje na qudit fakti se edhe pse AK thot shume çart se i ka makinerite e njëjta si ne llotin 3 ashtu edhe ne llotin 5 e besa edhe ne te gjitha tjerat lloti , ktu apert edhe përkundër këtyre fakteve eksperti shqyrtues e merr ankesën e OE si te bazuar.

Duke i par gjitha këto parregullsi nga ekspertiza e ekspertit shqyrtues kerkojm nga OSHP qe ti shoshit faktet mire ti merr parasysh faktet tona dhe këta OE ti shpall te pa pergjegjshem pasiqe duke i len faktet ne gjys dhe duke nzerr vendime ne favor te detyre OE pa i shoshitur faktet mire kta me vonë këto vendime te OSHP po i përdorin pikërisht kundër OSHP, dhe po es Shtyn ket tender me ankesa te pa përgjegjshme ne pafundësi.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: **23.11.2020**, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesat janë parashtruar kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Paneli shqyrtues në vazhdim jep konstatimet lidhur me pretendimet ankimore te OE “I.T.K” Shpk:

Lidhur me pretendimin e ankuesit se AK gjatë rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se numri mesatar i te punësuarve në tri vitet e fundit(2015,2016 dhe 2017) nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit,

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se në dosjen e tenderit, përkatësisht në Njoftimin për Informata Shtesë ose përmirësim gabimi tek kërkesa 4 është kërkuar që Mesatarja e të punësuarve (që janë në listën e pagave) në tri vitet e fundit duhet të jetë min. 10 të punësuar. Nëse oferta përfshin me shume se një LOT (Pjesë), numri i personelit duhet te rritet në varësi te numrit te lloteve për të cilat oferton.

OE "I.T.K"Shpk në ofertën e tij ka prezantuar numrin e stafit 32 për vitin 2017, për vitin 2016 ka prezantuar numrin e stafit 22 dhe për vitin 2015 numrin prej 26.

Paneli shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH. nr 455-464/18 të datës 05.10.2018.

Lidhur me vendimin e Autoritetit Kontraktues se OE ankues I.T.K"Shpk nuk e plotëson kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional për pajisjet e kërkuara ku sipas këtij vendimi të AK-së, OE ankues ka ofertuar në 6 lot, mirëpo pajisjet i ka ofruar vetëm për tri llote dhe sipas AK-së, ky OE është shpërblyer me kontratë për tri llote në këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH. nr 455-464/18 të datës 05.10.2018.

Paneli shqyrtues në vazhdim jep konstatime lidhur me pretendimet ankimore te GRUPIT TË OE ANKUES "DOREARTI"SHPK.; "BENI COM" SHPK; "LINDI MARKINGS"SHPK

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "Dorearti"Shpk; "Beni-com" Shpk ; "Lindi Markings" Shpk, se AK gjatë procesit të rivlerësimit ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se nuk plotëson kërkesën e kapacitetit ekonomik dhe financiar të dosjes së tenderit,

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional sqaron se në dosjen e tenderit është kërkuar që OE duhet të ketë kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (Mjete të gatshme në xhirollogari nga kompania në bankë në vlerë prej së paku 100,000.00 €, ose qasje në kredi nga një bankë), e dëshmuar me deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose qasje në kredi të pakushtëzuar, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar.

Grupi i OE"Dorearti"Shpk;"Beni com"Shpk ; "Lindi Markings"Shpk ka dorëzuar një Letër Referencë të ProCredit Bank duke specifikuar se ProCredit Bank do të konsideroj mbështetjen financiare duke u bazuar në kapacitetin e tij financiar dhe nëse plotësohen kushtet e përcaktuara nga Banka për financimin ne fjalë.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues profesional sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH.nr 181-182-191/19 të datës 19.06.2019,citat një pjesë të vendimit"Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton lidhur me letër përkrahjen nga bankat për OE në fjalë

se në lëndën e AK gjenden shkresat e lëshuara nga Procredit Bank me datën 11.06.2018, në të cilat dëshmohet gjendja e llogarisë bankare e OE "Dorearti" në vlerë mbi 100,000.00 € (mbi Njëqindmijë euro), të cilat shkresa grupi i OE ankues i ka dorëzuar në AK, pas kërkesës së AK që grupi i OE ankues konform nenit 72 të LPP-së, të dorëzoj dëshmi shtesë për ta sqaruar përkrahjen nga banka lidhur mjetet e gatshme në vlerë prej 100,000.00 €.

Andaj pretendimi ankimor është i bazuar dhe AK është e obliguar ta respektoj vendimit e lartcekur.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "Dorearti" Shpk; "Beni com" Shpk; "Lindi Markings" Shpk, se AK gjatë procesit të rivlerësimit ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se nuk plotëson kërkesën 3. të kapacitetit teknik dhe profesional, ku është kërkuar lista e kontratave të realizuara jo më pak se 500,00.00 € në tri vitet e fundit të lëmisë së kërkuar që sipas OE ankues kontratat dhe referencat e prezantuara e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues profesional sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH.nr 181-182-191/19 të datës 19.06.2019, citat një pjesë të vendimit" Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton se pretendimi i lartpërmendur është i bazuar për faktin se grupi i OE ankues se bashku me dosjen e tenderit kanë dorëzuar lista të projekteve të realizuara të lëmisë së kërkuar në periudhën e shkuar tre vjeçare (2014, 2015 dhe 2016) të shoqëruara me kontrata dhe referenca/raporte të pranimi teknik konform kërkesës dhe dëshmisë së parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit si vijon : lista e kontratave të realizuara jo më pak se 500.000.00 € të lëmisë së kërkuar në periudhën e shkuar tre vjeçare (2014, 2015 dhe 2016). Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e kërkuar (Sinjalizim horizontal dhe Vertikal, Pahi Elastike, Mirëmbajtja e Ndriçimit rrugor, Mirëmbajtja e Semaforëve, Mirëmbajtja e Numëruesve të Trafikut).

Andaj konstatojmë se ky pretendim është gjykuar më parë nga OSHP dhe pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se AK ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se pajisjet e ofruara nuk janë konform kërkesës së kapacitetit teknik dhe profesional dhe specifikimit teknik në dosje të tenderit.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional sqaron se në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të ofrojë dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapaciteteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit), e noterizuar ose origjinal. OE duhet të sjell dëshmi (specifikimin për pajisjen) për pajisjet, të cilat ka ndërmend t'i angazhoj për këtë projekt (pajisjet duhet të verifikohen nga noteri sipas procedurës së verifikimit të pajisjeve).

Grupi i OE“Dorearti”Shpk;”Beni com“Shpk ; ”Lindi Markings”Shpk ka dorëzuar një raport për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike,dy certifikata të regjistrimit të automjetit dhe një dokument unik doganor me nr IE0283639D për pajisjen makinë për shënimin e vijave në asfalt.

Dokumenti unik doganor është në emër të N.P.T “Noli” Xërxë, Rahovec dhe OE ankues nuk ka ofruar ndonjë dëshmi që kjo pajisje është në pronësi të saj apo ndonjë dëshmi të blerjes apo marrjes me qira siç është kërkuar në dosje të tenderit. Gjithsesi AK konform nenit 72 të LPP-së mund të kërkojë sqarime apo dokumente shtesë nga OE për këtë pajisje.

Oferta e grupit të OE“Dorearti”Shpk; “Beni com“Shpk ; “Lindi Markings”Shpk nga AK është shpallur e përgjegjshme përfshirë këtu edhe çështjen e pajisjeve por është vlerësuar si ofertë më e shtrenjtë dhe nuk është rekomanduar për kontratë siç është rasti i vendimit të AK nr. ZP 36/2018 të datës 02.07.2018. Pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar

Lidhur me pretendimin e grupit të OE“Dorearti”Shpk; “Beni com” Shpk ; “Lindi Markings”Shpk- se AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me vendimet paraprake të OSHP-së.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional sqaron se në Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues (B58) të datës 31.08.2020,AK njofton se anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se të gjitha ofertat e pranuar janë të papërgjegjshme duke sqaruar në letrat standarde për tenderuesit e eliminuar se vlerësimi i ofertave është bërë duke u bazuar në dosjen e tenderit, jo të formularit B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara për arsye se nuk është korrigjuar dosja e tenderit. Me datë 01.08.2017 është publikuar njoftimi për kontratë, ndërsa me datë 21.08.2017; 31.08.2017; 04.09.2017; 07.09.2017 dhe 11.04.2018 është bërë korrigjimi i njoftimit për kontratë, mirëpo dosja e tenderit nuk është korrigjuar asnjëherë.

Paneli shqyrtues konform Eksperti shqyrtues profesional konstaton se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH.nr.906-907-922-925-926/20 të datës 30.01.2020,citat një pjesë të vendimit “Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton se AK me datën 01.08.2017 ka publikuar njoftimin për kontratë, ndërsa me datat: 21.08.2017 , 31.08.2017,04.09.2017 dhe 07.09.2017 përmes “Formularit standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara B54” ka bërë korrigjimin e njoftimeve të publikuara (njoftimi për kontratë dhe dosjes së tenderit),andaj bazuar në pikën 47.11 të RRUOPP, sqarimin e KRPP-së të datës 11.04.2019 si dhe praktikat e prokurimit publik dokumentet në fjalë konsiderohen pjesë e dosjes së tenderit si dhe të njëjtat dokumente respektivisht pjesët e korrigjuara të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit me këto dokumente, duhet të merren për bazë nga AK me rastin

e vlerësimit të ofertave, e jo të konsiderohen dokumente të ndryshme nga dosja e tenderit”. Andaj pretendimi ankimor është i bazuar.

Paneli shqyrtues në vazhdim jep konstatime lidhur me pretendimet ankimore të OE ANKUES “SELECT PRIMA” SHPK

Lidhur me pretendimin e OE “Select Prima” Shpk, se AK gjatë rivlerësimit pa të drejte ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se ka ofruar çmime me më shumë se dy numra pas presjes dhjetore që konform Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, paragrafit 18.3, çdo numër i shënuar pas numrit të dytë (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës dhe rrjedhimisht çmimet e ofruara janë me vlerë 0.00.

Paneli shqyrtues sqaron se nëse AK konsideron se çmimet janë jo normalisht të ulëta duhet ti trajtoj konform nenit 61 të LPP-së.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE Select Prima” Shpk, se AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me vendimet paraprake të OSHP-së,

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional sqaron se në Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues (B58) të datës 31.08.2020, AK njofton se anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se të gjitha ofertat e pranuar janë të papërgjegjshme duke sqaruar në letrat standarde për tenderuesit e eliminuar se vlerësimi i ofertave është bërë duke u bazuar në dosjen e tenderit, jo të formularit B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara për arsye se nuk është korrigjuar dosja e tenderit. Me datë 01.08.2017 është publikuar njoftimi për kontratë, ndërsa me datë 21.08.2017; 31.08.2017; 04.09.2017; 07.09.2017 dhe 11.04.2018 është bërë korrigjimi i njoftimit për kontratë, mirëpo dosja e tenderit nuk është korrigjuar asnjëherë.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues konstaton se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH. nr. 906-907-922-925-926/20 të datës 30.01.2020, citat një pjesë të vendimit “Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton se AK me datën 01.08.2017 ka publikuar njoftimin për kontratë, ndërsa me datat: 21.08.2017, 31.08.2017, 04.09.2017 dhe 07.09.2017 përmes “Formularit standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara B54” ka bërë korrigjimin e njoftimeve të publikuara (njoftimi për kontratë dhe dosjes së tenderit), andaj bazuar në pikën 47.11 të RRUOPP, sqarimin e KRPP-së të datës 11.04.2019 si dhe praktikën e prokurimit publik dokumentet në fjalë konsiderohen pjesë e dosjes së tenderit si dhe të njejtat dokumente respektivisht pjesët e korrigjuara të njoftimit për kontratë dhe dosjes së

tenderit me këto dokumente, duhet të merren për bazë nga AK me rastin e vlerësimit të ofertave, e jo të konsiderohen dokumente të ndryshme nga dosja e tenderit”. Andaj pretendimi ankimor është i bazuar

Paneli shqyrtues në vazhdim jep konstatime lidhur me pretendimet ankimore të OE ANKUES “RSM COMPANY” SHPK

Lidhur me pretendimin e OE “RSM Company” Shpk, se AK gjatë rivlerësimit ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se nuk ka ofruar dëshmi për pajisjen nr 2 konform kërkesës së dosjes së tenderit,

Paneli shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-se, PSH. nr 181-182-191/19 të datës 19.06.2019.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE “RSM Company” Shpk se oferta e tyre është eliminuar me arsyetimin se nuk ka ofruar një deklaratë me shkrim e cila do të përfshinte një zbërthim të pjesëve relevante të tenderit konform nenit 61 të LPP-së Tenderët Jo-Normalisht të Ulët dhe Rregullat për tenderët Jo-Normalisht të Ulët. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se Me datë 21.08.2020, AK përmes Letrës standarde për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët ka kërkuar nga OE “RSM Company” Shpk që të jep një shpjegim detal të elementeve përbërëse të tenderit lidhur me disa çmime të cilat nuk korrespondojnë me çmimet e tregut.

Me datë 30.09.2020, eksperti shqyrtues përmes e-mailit ka kërkuar nga OE “RSM Company” Shpk nëse i është përgjigjur kërkesës së AK-së për sqarime të elementeve të tenderit.

Në të njëjtën datë nga OE “RSM Company” Shpk eksperti ka pranuar sqarime se me datë 24.08.2020 kanë dërguar tek zyrtari i AK-së dokumentin me sqarime për elementet e tenderit.

OE “RSM Company” Shpk në dokumentin e dërguar ka sqaruar për të gjitha pozicionet e kërkuara duke kalkuluar kostot për secilin pozicion/element të tenderit duke ja bashkangjitur dhe faturat e furnizuesve dhe dudat doganore të materialeve.

Andaj paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se është i paqartë arsyetimi i AK-së se OE nuk ka ofruar dëshmi sipas kërkesës apo cila nga sqarimet është në kundërshtim me kërkesën e AK-së. Pretendimi ankimor është i bazuar

Sa i përket pretendimit tjetër se dosja për Inxhinierin e Ndërtimtarisë-Drejtimi Konstruktiv z Sefedin Shala nuk është konform kërkesës së dosjes së tenderit. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH. nr. 15-169-173/18 të datës 05.06.2018 në të cilin pretendimi ankimor i OE ankues është gjykuar si i bazuar.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE "RSM Company" Shpk, se AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me vendimet paraprake të OSHP-së,

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional sqaron se në Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues (B58) të datës 31.08.2020, AK njofton se anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se të gjitha ofertat e pranuar janë të papërgjegjshme duke sqaruar në letrat standarde për tenderuesit e eliminuar se vlerësimi i ofertave është bërë duke u bazuar në dosjen e tenderit, jo të formularit B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara për arsye se nuk është korrigjuar dosja e tenderit. Me datë 01.08.2017 është publikuar njoftimi për kontratë, ndërsa me datë 21.08.2017;31.08.2017;04.09.2017;07.09.2017 dhe 11.04.2018 është bërë korrigjimi i njoftimit për kontratë, mirëpo dosja e tenderit nuk është korrigjuar asnjëherë.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues profesional sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH. nr. 906-907-922-925-926/20 të datës 30.01.2020.

Paneli shqyrtues në vazhdim jep konstatime lidhur me pretendimet ankimore të OE ANKUES "TSR"SHPK;"IDK KONSTRUKSION" ;"2T"

Lidhur me pretendimin e grupit të OE TSR"Shpk & "IDK Konstruktion" & "2T" (ish Sinjal RKS-Shpk), se AK gjatë procesit të rivlerësimit ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se nuk plotëson kërkesën 3. të kapacitetit teknik dhe profesional, ku është kërkuar lista e kontratave të realizuara jo më pak se 500,00.00 € në tri vitet e fundit të lëmisë së kërkuar që sipas OE ankues kontratat dhe referencat e prezantuara e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional sqaron se në dosjen e tenderit është kërkuar që OE të dorëzojnë listën e kontratave të realizuara jo më pak se 500.000.00 € të lëmisë së kërkuar në periudhën e shkuar tre vjeçare (2014, 2015 dhe 2016). Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e kërkuar (Sinjalizim horizontal dhe Vertikal, Pahi Elastike, Mirëmbajtja e Ndriçimit rrugor, Mirëmbajtja e Semaforëve, Mirëmbajtja e Numëruesve të Trafikut)

Grupi i OE TSR"Shpk & "IDK Konstruktion" & "2T" (ish Sinjal RKS-Shpk) se bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar listat e kontratave për dy anëtarët e konzorciumit, Më poshtë po e listojmë vetëm një kontratë e cila e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit.

-Kontrata në mes të Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe OE "IDK Konstruktion", e lidhur me datë 31.12.2014 për "Përmirësimin e sigurisë dhe i sinjalistikës rrugore në superstradën Tiranë-Durrës dhe segmentin rrugor Kashar-Rinas Loti 2 " në vlerë prej 295,101,639.00 lekë apo 2,459,180,325.00 €.

Gjithashtu është i bashkangjitur edhe Raporti i pranimit sipas të cilit punimet janë realizuar në shumë prej 295,097,534.00 lekë me datë 03.09.2015.

Nga kjo shumë OE "IDK Konstruktion ka kryer 60% të punimeve të kontratës ndërsa nënkontraktori "Madenkost" Shpk ka realizuar 40% të kontratës.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues profesional konstaton se kjo kontratë është konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe përmbush vlerën e kërkuar prej 500,000.00 €. Pretendimi ankimor është i bazuar Lidhur me pretendimin e grupit të OE TSR"Shpk &"IDK Konstruktion" & "2T" (ish Sinjal RKS-Shpk),se AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me vendimet paraprahe të OSHP-së.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional sqaron se në Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues (B58) të datës 31.08.2020,AK njofton se anulon aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se të gjitha ofertat e pranuar janë të papërgjegjshme duke sqaruar në letrat standarde për tenderuesit e eliminuar se vlerësimi i ofertave është bërë duke u bazuar në dosjen e tenderit, jo të formularit B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara për arsye se nuk është korrigjuar dosja e tenderit. Me datë 01.08.2017 është publikuar njoftimi për kontratë, ndërsa me datë 21.08.2017; 31.08.2017; 04.09.2017; 07.09.2017 dhe 11.04.2018 është bërë korrigjimi i njoftimit për kontratë, mirëpo dosja e tenderit nuk është korrigjuar asnjëherë.

Sqarojmë se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH. nr. 906-907-922-925-926/20 të datës 30.01.2020, citat një pjesë të vendimit "Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit konstaton se AK me datën 01.08.2017 ka publikuar njoftimin për kontratë, ndërsa me datat: 21.08.2017 , 31.08.2017, 04.09.2017 dhe 07.09.2017 përmes "Formularit standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara B54" ka bërë korrigjimin e njoftimeve të publikuara (njoftimi për kontratë dhe dosjes së tenderit), andaj bazuar në pikën 47.11 të RRUOPP, sqarimin e KRPP-së të datës 11.04.2019 si dhe praktikën e prokurimit publik dokumentet në fjalë konsiderohen pjesë e dosjes së tenderit si dhe të njejtat dokumente respektivisht pjesët e korrigjuara të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit me këto dokumente, duhet të merren për bazë nga AK me rastin e vlerësimit të ofertave, e jo të konsiderohen dokumente të ndryshme nga dosja e tenderit", pretendimi ankimor është i bazuar.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët dhe se anulimi i aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 44 të RRUOPP.

Paneli shqyrtues vije ne përfundim se, dhe përkundër konstatimeve te panelit shqyrtues si me lart, gjithashtu edhe ne vendimet e mëparshme, pasi që janë lëshuar shume vendime dhe këtë aktivitet e kane shqyrtuar disa eksperte, gjithherë paneli ka konstatuar duke u bazuar ne sqarimet e eksperteve, andaj Autoriteti Kontraktues obligohet qe konform nenit 59 te LPP-së me kujdesin me te madh te beje rivlerësimin e ofertave dhe te shpalle fitues Operatorin qe i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate duke e respektuar nenin 1, 6 e 7 te LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA

vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 ak – ministria e infrastrukturës”
- 1x1 oe -“i.t.k” shpk -
- 1x1 “dorearti”shpk;”beni com“shpk ;
- 1x1”lindi markings” shpk-pejë “
- 1x1select prima”shpk -“rsm company”shpk
- 1x1 “tsr”shpk (ish sinjal shpk
- 1x1 arkivës së oshp-së;
- 1x1 për publikim në ueb- faqe të oshp-së.